



|   |   |                                     |   |
|---|---|-------------------------------------|---|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO |   |                                     |   |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                                  |   |                                     |   |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE     |   |                                     |   |
| DATE E VËNDRDORËZUARIT<br>DATE OF RECEIVING SUBMITTER:      |   | 10.12.2021                          |   |
| Nësiat Org.<br>Org. Jeka<br>Org. Unit                       | Shif. Klasif.<br>Klasif. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. | Nr. i faqeve<br>Br. Stranica<br>No. Pages |
| 01  | 47  | 2536                                | 20  |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Prishtinë,  
10.12.2021

Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike,  
Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Lënda: Dorëzimi i Planit Vjetor të Auditimit për sezonin 2021-22**

I/E nderuar,

Në përputhje me neni 20.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, ju dorëzojmë Planin Vjetor të Auditimit për sezonin audituese 2021-22.


Me respekt,

**Vlora Spanca**

Auditore e Përgjithshme



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## Plani Vjetor i Auditimit

(sezoni e auditimit 1 shtator 2021 deri më 31 gusht 2022)

Prishtinë, dhjetor 2021

## Tabela e përmbajtjes

|   |    |
|---|----|
| 1. Vizioni, Misioni dhe Vlerat .....              | 3  |
| 2. Hyrje .....                                    | 4  |
| 3. Llojet dhe Procesi i auditimit .....           | 5  |
| 4. Objektivat vjetore dhe Plani i auditimit ..... | 8  |
| 5. Buxheti dhe burimet njerëzore .....            | 13 |
| 6. Zbatimi .....                                  | 14 |

### Shtojca 1. Subjektet dhe temat që do të auditohen

## **1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT**

ZKA-ja është institucion i pavarur në shërbim të qeverisjes së mirë dhe publikut. ZKA-ja është e përkushtuar në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues dhe ligjor, me një vizion të qartë strategjik.

### **Vizioni**

*“Institucion i besueshëm i auditimit,  
që përmirëson qeverisjen në sektorin publik,  
në interes të qytetarëve”*

### **Misioni**

*“Përmes auditimeve cilësore  
fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike  
për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik  
të burimeve kombëtare”*

### **Parimet që i zbaton ZKA**

*Pavarësia*

*Profesionalizmi*

*Integriteti*

*Transparenca*



## 2. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit ("ZKA") si Institucion Suprem i Auditimit ("ISA") kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ("Ligjin e ZKA-së").

ZKA auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është miratuar. ZKA poashtu kryen auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe ofrimit të tyre me çmime të arsyeshme.

Sipas Ligjit të ZKA-së parashihet Planin Vjetor i Auditimit (PVA), ky dokument përfshinë të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues 2021/22 dhe dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit, deri më 31 tetor.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë në konsideratë: Ligji i ZKA-së, Plani strategjik i ZKA-së (2018-2021), përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë<sup>1</sup>, përzgjedhja e temave për auditime të performancës bazuar në vlerësimin e ndikimit në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike në përgjithësi, nivelin e rrezikut (qasjen e bazuar në rrezik) dhe aktualitetin e tyre, përfshirja edhe auditimin e ndërmarrjeve publike, adresimi i kërkesave specifike të palëve të interesit etj.

Përgjithësisht, Plani vjetor i auditimit përfshinë informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditorja e Përgjithshëm për sezonin auditues, përfshinë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin, rezultatet dhe rreziqet që mundet të ballafaqohet ZKA.

Vlerësojmë që sezoni i ardhshëm auditues do të jetë mjaft sfidues, pasi që do të realizohet (kryhet) në rrethana të shtrirjes së pandemisë në tërë vendin. Ndikimi i pandemisë ka qenë i dukshëm edhe gjatë sezonit të kaluar të auditimit, pasi që entitetet audituese kanë punuar me staf të reduktuar dhe në periudha të caktuara kohore, sidomos kur auditorët e ZKA-së ishin në terren, shumë prej entiteteve ose ishin mbyllur ose punonin nga distanca/shtëpia. Për më tepër disa prej auditorëve ishin prekur nga virusi Covid 19 dhe janë detyruar të izoloohen dhe t'i nënshtrohen trajtimit mjekësor. Kjo situatë e ka vështirësuar tej mase realizimin e Planit Vjetor të Auditimit 2020/21. Vlen të theksohet që përkundër këtyre sfidave dhe vonesave në përfundimin e auditimeve individuale, ZKA-ja ka arritur që të dorëzoj, brenda afatit ligjor, Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës.

Një sfidë tjetër e rëndësishme gjatë këtij sezoni do të jetë zbatimi paralel i metodologjisë së re për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë që është zhvilluar me përkrahjen e partnerit të projektit

---

<sup>1</sup> Megjithëse në ligjin për ZKA përdoret termi auditim i rregullsisë, sipas SNISA-ve të përditësuara nuk përdoret me tutje ky term. Ky lloj i auditimit tashme emërtohet me termin Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë, pasi që standardet SNISA-t i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë.

të binjakëzimit, Zyres Kombëtare të Auditimit të Polonisë, si dhe sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit (SITA). Me qëllim të funksionalizimit të plotë të tyre i tërë personeli i ZKA-ka ndjekur trajnime për zbatimin e metodologjisë së re audituese, e më pas edhe atë për përdorimin e sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit (SITA) dhe varësisht prej nevojës do ketë trajnime tjera deri në përvetësimin e plotë të tyre.

Auditimet do të realizohen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ("SNISA"), duke u bazuar në parimet univerzale të ISA-ve dhe të ZKA-së si, pavarësia, profesionalizmi, integriteti dhe transparencja. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për palët e interesuar dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit.

### 3. LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

#### 3.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e ZKA-së, gjatë sezonit 2021/22 do të kryhen këto lloje të auditimeve:

- ❖ **Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë** të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin aktual); dhe
- ❖ **Auditime të performancës**, përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.

**Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë:** përfshinë auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të Pasqyrave Financiare, nëse Pasqyrat Financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta (apo të paraqitura drejtë) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet<sup>2</sup>.

Sipas SNISA-ve të përditësuara, auditimet e rregullsisë së PVF-ve janë auditime financiare dhe auditime të pajtueshmërisë (qasje e kombinuar), prandaj në vazhdim po japim përkufizimet për objektivat e llojeve të auditimeve.

- ❖ **Auditimi financiar-** Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisë nivelin e besimit tek përdoruesit e pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga

---

<sup>2</sup> "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë përputhshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutores, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituara. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira.



ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën raportuese në fuqi; si dhe të ofrojë siguri të arsyeshme se informacioni financiar në Raportin Vjetor Financiar është i vërtetë, i drejtë dhe konsistent me Kornizën për Raportim Financiar dhe Kornizën Rregullative. Prandaj, objektivi është ngritja e shkallës së besueshmërisë së përdoruesve të synuar në Pasqyrat Financiare të audituara.

- ❖ **Auditimi i pajtueshmërisë-** Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është që të informojë përdoruesit nëse entitetet publike të audituara respektojnë vendimet e Kuvendit, ligjet, aktet legjislativë, politikat, kodet, praktikat e mira, si dhe ofruar siguri se proceset raportuese të kontabilitetit/financiare dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me autoritetet.

Qëllimi gjithëpërfshirës i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë është të rritet niveli i besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

Auditimet financiare dhe i pajtueshmërisë kryhen për çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

**Auditimet e performancës:** paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek njëri nga tri qasjet:

- ❖ qasjen e orientuar në *rezultate*, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- ❖ qasjen e orientuar në *problem*, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit(ve); ose
- ❖ qasjen e orientuar në *sistem*, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.

**Auditimet e teknologjisë së informacionit (TI).** Auditimi i TI-së definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfutur siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme. Në terma të

përgjithshëm, auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare, në auditimet e pajtueshmërisë, në auditimet e performancës, por mund të realizohen edhe si auditime të veçanta.

### 3.2 Procesi i auditimeve

**A. Procesi i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë-** bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (Metodologjia e qasjes së kombinuar) dhe SNISA-t. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga: njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve:

- ❖ planifikimi i auditimit;
- ❖ ekzekutimi i auditimit;
- ❖ dhënia e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit;
- ❖ raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- ❖ përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Procesi i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Metodologji dhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë, të cilat kanë përgjegjësinë ta sigurojnë menaxhmentin që auditimet janë kryer duke u bazuar në metodologjinë e aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe SNISA-t.

**B. Procesi i auditimeve të performancës** - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës kryhet nëpër fazat në vijim:

**Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit të performancës**



**Faza 1. Planifikimi.** Përfshinë propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet shqyrtohen përmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar. Në këtë fazë poashtu, ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rreth temës përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.



**Faza 2. Ekzekutimi i punës në terren.** Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren dhe të hartojnë draft raportin e auditimit.

**Faza 3. Raportimi.** Ekipi auditues përfundon hartimin e raportit të auditimit, i cili duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj. Pasi që raporti ka kaluar nëpër kontrollin e cilësisë dhe janë dhënë aprovimet e duhura, bën publikimin e tij.

**Faza 4. Përcjellja e auditimit.** Pasi të ketë kaluar një periudhë e përshtatshme kohe, ZKA-ja mund të kryejë një vlerësim të progresit të entitetit të audituar në përgjigjet ndaj gjetjeve të auditimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe të raportojë për to përmes një auditimi përcjellës. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellëse vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

#### 4. OBJEKTIVAT VJETORE DHE PLANI I AUDITIMIT

Objektivat e ZKA-së për sezonin auditues 2021/22 bazohen në Planin Strategjik të ZKA-së 2018-2021 me të cilin synohet përveç tjerash avancimi i metodologjisë së auditimit dhe përmirësimi i mëtejme i cilësisë së auditimeve. Për sezonin e auditimit 2021/22 janë planifikuar 130 auditime, si dhe 4 auditime të papërfunduara nga viti i kaluar, siç janë paraqitur në Tabelën 1. Plani auditues përfshin të gjitha auditimet e detyrueshme të rregullsisë të përcaktuara me nenin 18.3 të Ligjit të ZKA-së, prej gjithsejt 91, 14 projekte të financuara nga fondet e jashtme; 12 ndërmarrje publike dhe 10 auditime të performancës<sup>3</sup> dhe 3 auditime sipas kërkesës.

**Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2021/2022**

| Llojet e auditimit  | Numri i auditimeve |
|---|--------------------|
| Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) <sup>4</sup> | 117                |
| ✓ Buxheti i Kosovës   | 1                  |
| ✓ Institucione të nivelit qendror                                       | 52                 |
| ✓ Komuna  | 38                 |
| ✓ Ndërmarrje publike  | 12                 |
| ✓ Projekte të financuara nga fondet e jashtme                           | 14                 |

<sup>3</sup> Përveç auditimeve të reja që janë paraparë me këtë plan, në proces të finalizimit janë 4 auditime të performances që janë në vazhdim nga sezoni i kaluar i auditimit.

<sup>4</sup> Auditimi i 19 Institucioneve të pavarura dhe 6 komunave do të përkrahet nga një kompani private e auditimit.

|   |            |
|---|------------|
| <b>Auditime të performancës<sup>5</sup></b>   | <b>17</b>  |
| ✓ Auditime të performancës (prokurim & TI)    | 10         |
| ✓ Auditimet me kërkesë                        | 3          |
| ✓ Auditimet e pa përfunduar nga viti i kaluar | 4          |
| <b>Gjithsej</b>                               | <b>134</b> |

Lista e të gjitha auditimeve është paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë do të finalizohen deri më 30 Qershor 2021. Sipas afatit ligjor, Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit të ardhshëm<sup>6</sup>. Ndërsa, auditimet e performancës dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Angazhimi i burimeve njerëzore është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore si dhe kualifikimin dhe përvojën e stafit; madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë dhe kompleksitetin e temës audituese; si dhe bazuar në përvojën nga vitet paraprake.

#### 4.1 Fokusi i auditimeve të rregullsisë

Për dallim nga sezoni i kaluar, numri e auditimeve të rregullsisë është rritur. Menaxhmenti i ZKA-së ka vendosur të kryejë auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë për transmetuesin publik të Kosovës (RTK). Poashtu, në këtë vitë do vazhdohet me numrin e njëjtë (12-sosh) të auditimeve të NP-ve<sup>7</sup> nga ZKA. Ndërsa, auditimi i 19 institucioneve të pavarura dhe gjashtë komuna do të përkrahjet nga një kompani private e auditimit, përderisa opinioni i auditimit do të jepet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe SNISA-t.

Për sezonin auditues 2021/22, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) së 14 projekteve të financuara nga donatorët. Prej të cilave, 12 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe dy të financuara nga Agjencioni Suedez për Zhvillim (SIDA).

<sup>5</sup> Për temat e zgjedhura të auditimit të performances, së pari do të kryhen parastudimet dhe pastaj do të vendoset për auditimin e tyre.

<sup>6</sup> Në respektimin e këtij afati mund të ndikoj situata pandemike!

<sup>7</sup> Në përzgjedhjen e NP-ve është marrë në konsideratë mbulueshmëria në tri nivele të organizimit (NP-të e nivelit qendror, rajonal dhe lokal), si dhe mbulueshmëria rajonale.



## 4.2 Fokusi i auditimeve të performancës

Temat për auditime të performancës përzgjidhen duke pasur parasysh mundësinë e ndikimit në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike në përgjithësi.

Në planin auditues 2021/2022, numri i auditimeve të performancës është rritur, duke përfshirë tema nga fusha të rëndësishme, si: arsimit, ekonomia, mjedisi, transmetuesi publik, investimet publike (prokurimi publik), dhe teknologjia e informacionit. Përveç fushave që ZKA mbulon thuaja se çdo vit me auditimet e performancës, këtë vit ka shtrirë fushëveprimin edhe më shumë në ndërmarrje publike si dhe transmetuesin publik. Për të përcaktuar planin vjetor të auditimeve të performancës, janë kërkuar propozime për temat nga të auditorët e ZKA-së. Pastaj temat e propozuara janë rishikuar nga drejtorët e departamenteve të auditimit dhe më pas janë diskutuar me Auditorën e Përgjithshme dhe janë aprovuar nga ajo. Në këtë sezone audituese, në plan për auditim janë përfshirë edhe tema me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në vijim janë dhënë disa informata për fushat e përzgjedhura:

**Arsimi.** Arsimit është elementi kyq në zhvillimin e kapitalit njerëzor sidomos për një shtet si Kosova ku shumica e popullsisë ka moshë të re. Një nga çështjet që raportohet në vazhdimësi në raportet e ZKA-së dhe në media është që sektori i arsimit vazhdon të përballet mungesë të progresit në cilësinë e arsimit. Progresi dhe përmirësimet duhet të bëhen veçanërisht në qasjen në arsim cilësor në nivelin fillor dhe të mesëm të ultë si dhe për grupet me nevoja të veçanta. Progres pritet edhe në finalizimin e kornizës së re kurrikulare për arsimin bazë me tekste shkollore cilësore, trajnim për profesionet e kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve nga Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ShEPC) në Arsimin e Lartë. Nxënësit kosovarë po shënojnë rezultatet relativisht të mira në testet e bazuara në shkollë në ato të standardizuara dhe në testin kombëtar të arritshmerisë. Mirëpo, sfida mbeten rezultatet e dobëta në testet ndërkombëtare si në testin PISA. Andaj këtë vit ZKA do të kryej auditimin me temën “Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare- PISA”. Objektivi i këtij auditimi do të jetë nëse MASHT-i ka marrë masat e nevojshme për të vlerësuar arsyet që po shpijnë në rezultate të tilla nga testet ndërkombëtare.

**Zhvillimi ekonomik dhe mjedisi.** Viteve të fundit, ZKA ka publikuar një numër të konsiderueshëm të auditimeve në fushën e zhvillimit ekonomik dhe në ruajtjen e mjedisit, duke trajtuar tema me interes si: Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari dhe mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale. Këtë sezone, ZKA ka filluar me parastudimin për auditimin e Hidrocentraleve - licencimi dhe monitorimi i tyre. Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) përbëjnë një element të rëndësishëm të sektorit të energjisë në Kosovë. Zhvillimi i Hidrocentraleve është njëri nga mjetet më të rëndësishme për shfrytëzimin maksimal të resurseve natyrore në vend për prodhimin e energjisë elektrike. Sipas



raportit të progresit Kosova vlerësohet të ketë probleme me arritjen e targetit mbi prodhimin e energjisë hidrike si rezultat i procedurave dhe vonesave burokratike/administrative gjatë procesit të pajimit me licenca të ndryshme. Në kuadër të sektorit të zhvillimit ekonomik, ZKA ka vendosur të kryejë auditimin e performancës së Trepçës. Kosova është e pasur me resurse minerare. Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve mund të sigurojë mbështetje për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Gjendja aktuale e sektorit minerar nuk po mundëson arritjen e këtij qëllimi. Kompania më e madhe minerare në Kosovë është “Trepça Sh.A.”, e cila sfidë kryesore ka përmirësimin e performancës së saj financiare dhe operative. Andaj, ZKA ka vendosur që këtë vit të zhvilloj auditimin “Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A”.

**Transmetuesi Publik.** Radio Televizioni i Kosovës është subjekt jofitimprurës i cili operon me pesë televizione dhe dy radio. Themelues i RTK-së është Kuvendi i Kosovës dhe pjesa më e madhe e financiamit të këtij subjekti sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. RTK aktualisht financohet nga buxheti i shtetit me 0.7 % të të hyrave nga Buxheti i Kosovës duke përjashtuar disa lloje të hyrave (privatizimi, të hyrat e njëhershme, të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal). Përveç shpenzimeve që janë rritur vit pas viti në RTK, njëkohësisht është rritur edhe përqindja e financimit nga buxheti i shtetit. Andaj, ZKA ka vendosur për auditimin e RTK-së me objektivë vlerësimin nëse “Radio Televizioni i Kosovës ka shpenzuar paratë e alokuara nga buxheti i Kosovës sipas qëllimit për të cilin i janë ndarë, në pajtim me ligjin dhe ka arritur vlerën për para”.

**Prokurimi publik.** Përmes prokurimit publik, në vitin 2020, janë lidhur 10,935 kontrata në vlerë 499,311,906€. Gjithsej 158 autoritete kontraktuese (AK) ishin përfshirë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve të prokurimit, ndërsa për 16 institucione të pavarura aktivitetet e prokurimit i ka zhvilluar Agjencia Qendrore e Prokurimit. Nga gjithsej këto kontrata 8,039 janë nënshkruar nga organizatat buxhetore ndërsa 2,888 sosh kanë nënshkruar ndërmarrjet publike.

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë si dhe ato të performancës për prokurim publik të kryera gjatë vitit 2020 dhe viteve paraprake kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave në të gjitha fazat e prokurimit, nisur nga planifikimi, zhvillimi i procedurave, menaxhimi i kontratave dhe deri në finalizimin e projektit apo pranimin e punëve. Viteve të fundit, ZKA ka kryer auditimin e prokurimit për ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale, prokurimeve të centralizuara pjesa një dhe dy, procedurat me negociim pa publikim, tenderët në lloje, menaxhimin e kontratave të ndërtimit, Fondin Zhvillimor në komunat në veri të Kosovës si dhe dy auditime për grantet e performancës komunale të financuara nga DEMOS. ZKA-ja është në proces të finalizimit të raportit të auditimit të kontratës së centralizuar për shërbimet e transportit ajror dhe grantet e performancës komunale të financuara nga DEMOS për vitin fiskal 2020. Për sezonin auditues 2021/2022, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e projektit “Bashkimi i Qytetit” në Ferizaj. Ky auditim do të ketë shtrirje në tërë procesin e realizimit të këtij projekti që nga planifikimi, zhvillimi i procesurave, menaxhimi i kontratës e deri në vënien e tij në shfrytëzim për



qytetarët. Këtë vit do bëhet edhe auditimi i procedurave të prokurimit publik në KEK dhe KOSTT. Fokusi i këtyre auditimeve do jenë përfitimet nga këto investime dhe vlerësimi i pajtueshmërisë së procedurave të prokurimit si dhe arritja e qëllimeve për të cilat janë shpenzuar mjetet. Fushëveprimi i këtyre auditimeve do të përfshijë procedurat e zhvilluara në disa vite.

**Teknologjia e Informacionit (TI).** Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka bërë të mundur ruajtjen, procesimin dhe ofrimin e informacioneve në mënyrë elektronike. Me rritjen e aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është rritur edhe rëndësia dhe nevoja e auditimeve të TI-së. Në vitin 2021, ZKA-ja ka publikuar dy raporte të auditimit të TI-së, "Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës", "Auditimi i Sistemeve Elektronike për Menaxhimin e Granteve dhe Subvencioneve Bujqësore në Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural" si dhe janë mbështetur ekipet e auditimit financiar në Raportin Vjetor të Auditimit (ku është vlerësuar nëse Thesari ka krijuar ambient të sigurt në mënyrë që Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës të ruaj integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e tij) dhe në auditimin e Telekomit të Kosovës. Auditimet TI-së të kryera nga ZKA-ja kanë treguar se institucionet përgjegjëse kanë nevojë për përmirësime në qeverisjen dhe sigurinë e sistemeve të informacionit, nëpërmjet të cilave mundësohet menaxhimi i aktiviteteve në organizata.

Për sezonin auditues 2021/2022 janë planifikuar tri auditime në fushën e teknologjisë së informacionit, "Sistemi i Gjendjes së Regjistrimit Civil" dhe "Kontrollet e Informacionit në sistemin e pagave - PAYROLL", si dhe auditimi përcjellës i rekomandimeve të dhëna në RVA 2020 për SIMFK në pjesën e TI-së.

Objektivë e këtyre auditimeve do të jetë vlerësimi i kontrolleve të përgjithshme dhe të aplikacionit të Sistemit të Gjendjes Civile dhe Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Pagave si dhe ndërlidhja e tyre me sistemet e tjera. Ndërsa në auditimin përcjellës në SIMFK do të vlerësohet niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në RVA 2020.

#### 4.3 Metodologjia dhe sigurimi i cilësisë

Cilësia në auditim është kërkesë ligjore dhe e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA). Puna e personelit të angazhuar në kuadër të Departamenteve: Metodologji dhe Sigurimit të Cilësisë në Auditim bazohet në aktivitete të caktuara për krijimin e kushteve për kryerjen e punëve audituese me cilësinë e duhur si dhe në zbatimin e mekanizmave të përcaktuar për sigurimin e cilësisë në gjithë procesin e auditimit.

Aktivitetet themelore gjatë këtij sezoni do të fokusohen në:

- ❖ përditësimin e letrave të punës, përcjelljen dhe prezantimin e ndryshimeve në SNISA, ofrimin e mbështetjes profesionale për auditorët, identifikimin e nevojave për trajnime dhe ofrimin e tyre.
- ❖ përkujdesjen për zbatimin e metodologjisë së përditësuar përmes sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit;
- ❖ rishikimin e procesit të auditimit në të gjitha fazat dhe zbatimin e sigurimit të cilësisë në auditim, sipas një plani të veçantë të punës; dhe
- ❖ analizimin e të dhënave të caktuara dhe përpunimin e tyre për qëllime të auditimit.

## 5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

### 5.1. Buxheti

Zyra Kombëtare e Auditimit financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Për vitin 2021, buxheti i miratuar i ZKA-së është rreth 2,795,576€. Krahasuar me Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti për vitin 2021 shënon një ulje prej 10%. Kjo ulje është si rezultat i rishikimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimit dhe të ndryshimit të deklaratës së prioriteteve nga Qeveria e Kosovës.

Sipas kategorive ekonomike për vitin 2021, buxheti i rishikuar (Ligji nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021) për mallra dhe shërbime ishte zvogluar për 8% krahasuar me buxhetin fillestar, ndërsa për shpenzime komunale ishte zvogluar për 20%. Kurse në kategoritë paga e medijve dhe investime kapitale, nuk kishte pasur ndryshime buxhetore.

Me ndarjen e miratuar buxhetore për vitin 2021, ZKA-ja nuk ka ndryshime në numrin e punonjësve. Kjo e vështirëson përmbushjen e objektivave institucionale për përfshirjen e të gjitha organizatave buxhetore në auditimin e rregullsisë, pastaj përfshirjen në auditimin e rregullsisë të më shumë ndërmarrjeve publike si dhe rritjen e numrit të auditimeve të performancës, sidomos në këto rrethana të situatës pandemike në vend. Në mungesë të burimeve të mjaftueshme, ZKA-ja është e detyruar për çdo vit të kontraktoj një kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin e një numri të caktuar të organizatave buxhetore.

### 5.2 Burimet njerëzore dhe trajnimet

ZKA me buxhetin vjetor ka të miratuar 173 vende pune, mirëpo aktualisht ka të punësuar 165 punonjës. Numri prej 129 janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, profesionale, administrative dhe mbështetëse. Struktura kualifikuese e punonjësve auditues është e nivelit të lartë dhe në proces të përmirësimit të vazhdueshëm.



Për të arritur qëllimet strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar me SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelor për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Në ZKA, sipas planit vjetor të trajnimeve, mbahen trajnime të rregullta, kryesisht në muajt (gusht/shtator) kur auditorët kanë më pak angazhime në procesin e auditimit. Trajnimet mbahen nga ekspertët e ZKA-së dhe ata të jashtëm, pastaj një numër i konsiderueshëm i punonjësve përfitojnë trajnime nga partnerët e jashtëm si, Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë, Gjykata Evropiane e Auditorëve, Banka Botërore, USAID-i, etj.


Me organizimin e trajnimeve do të vazhdohet edhe për sezonin e auditimit 2021/22. ZKA-ja harton planin vjetor të trajnimeve që përfshinë trajnime nga personeli i ZKA-së dhe ekspertë të jashtëm. Përmbajtja e trajnimeve dhe mënyra e organizimit të tyre do të adaptohet në funksion të zbatimit të objektivave të përcaktuara dhe të menaxhimit të performancës individuale.

## 6. ZBATIMI

Plani vjetor do të zbatohet nga 1 shtatori 2021 deri më 31 gusht 2022. Gjatë muajit shtator dhe tetor i tërë personeli i ZKA-së ka ndjek trajnime për edukimin e vazhdueshëm profesional, auditorët e performancës kanë ndjek trajnime për shkathtësit analitike të organizuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë si dhe një pjesë e stafit drejtues kanë ndjek trajnime për sigurimin e cilësisë në auditim po ashtu të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë.

Për zbatimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument ZKA-ja do të përgatis plan operative audituese, sipas fushave, organizatave buxhetore dhe projekteve të caktuara.

Prishtinë, dhjetor 2021

  
\_\_\_\_\_  
**Vlora Spanca**

Auditore e Përgjithshme

**Shtojca 1.** Subjektet dhe temat që do të auditohen.

**A. AUDITIMET E RREGULLSISË**

**Tabela 2: Institucione të nivelit qendror [1 + 52 = 53]**

|    | <b>Entitetet nën auditim</b>                                     | <b>Buxheti 2021</b> |
|----|--|---------------------|
| 1  | Auditimi i Raportit Vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës  | 2,358,205,954       |
| 2  | Kuvendi i Kosovës  | 10,507,008          |
| 3  | Zyra e Presidentit   | 2,651,468           |
| 4  | Zyra e Kryeministrit   | 13,688,261          |
| 5  | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                     | 718,482,683         |
| 6  | Administrata Tatimore e Kosovës                                  | 12,949,924          |
| 7  | Dogana e Kosovës   | 11,080,588          |
| 8  | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                     | 5,797,675           |
| 9  | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural           | 69,569,587          |
| 10 | Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë               | 30,201,359          |
| 11 | Ministria e Ekonomisë  | 33,432,107          |
| 12 | Ministria e Shëndetësisë   | 93,100,461          |
| 13 | Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës               | 117,959,442         |
| 14 | Fondi i Sigurimeve Shëndetësore                                  | 7,901,325           |
| 15 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve                        | 35,475,708          |
| 16 | Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë                | 63,820,956          |
| 17 | Universiteti i Prishtinës  | 31,012,524          |
| 18 | Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit                             | 5,469,893           |
| 19 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës  | 145,043,995         |
| 20 | Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës                | 147,289,240         |
| 21 | Ministria e Drejtësisë   | 39,121,998          |
| 22 | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës                      | 31,656,327          |
| 23 | Ministria e Mbrojtjes  | 72,180,533          |
| 24 | Ministria e Zhvillimit Rajonal                                   | 3,866,729           |
| 25 | Keshilli Prokurororial i Kosovës                                 | 14,485,253          |
| 26 | Komsioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve                    | 1,338,992           |
| 27 | Këshilli Gjygjësor i Kosovës                                     | 29,094,592          |
| 28 | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*                       | 699,976             |
| 29 | Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës*                      | 1,199,272           |
| 30 | Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare* | 1,308,092           |
| 31 | Agjencioni Kundër-Korrupsion*                                    | 547,970             |
| 32 | Zyra Rregullatorit për Energji*                                  | 775,586             |
| 33 | Organi Shqyrtues i Prokurimit*                                   | 369,875             |
| 34 | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas*                              | 439,298             |
| 35 | Gjykata Kushtetuese e Kosoves                                    | 1,864,753           |



|    |  |            |
|----|--|------------|
| 36 | Autoriteti Kosovar i Konkurrencës*                           | 322,808    |
| 37 | Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore*                 | 195,108    |
| 38 | Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa*                   | 300,745    |
| 39 | Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës* | 377,235    |
| 40 | Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit*                 | 368,405    |
| 41 | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave*                        | 368,641    |
| 42 | Autoriteti i Aviacionit Civil*                               | 926,377    |
| 43 | Komisioni i Pavarur i Mediave*                               | 832,741    |
| 44 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve                               | 17,689,036 |
| 45 | Institucioni i Avokatit të Popullit                          | 1,269,279  |
| 46 | Akademia e Drejtësisë*                                       | 815,766    |
| 47 | Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës*      | 2,300,590  |
| 48 | Agjencioni për Informim dhe Privatësi*                       | 330,869    |
| 49 | Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale*           | 3,975,918  |
| 50 | Fondet në Mirëbesim  | -          |
| 51 | Agjencioni Kosovar i Privatizimit                            | 6,999,104  |
| 52 | Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror                   | 5,907,467  |
| 53 | Radio Televizioni i Kosovës                                  | 11,200,000 |

\*Institucionet e Pavarura, auditimi i së cilave do të përkrahet nga kompania private e auditimit.

**Tabela 3: Komuna [38]**

|    | Entitetet nën auditim | Buxheti 2021 |
|----|-----------------------|--------------|
| 1  | Prishtinë             | 87,630,627   |
| 2  | Obiliq                | 11,338,484   |
| 3  | Podujevë              | 23,106,090   |
| 4  | Fushë Kosovë          | 11,261,383   |
| 5  | Mitrovica e Jugut     | 21,084,056   |
| 6  | Graçanicë             | 6,989,847    |
| 7  | Mitrovica e Veriut    | 5,038,093    |
| 8  | Zubin Potok           | 2,340,221    |
| 9  | Zveçan                | 2,276,566    |
| 10 | Prizren               | 48,697,883   |
| 11 | Mamusha*              | 1,760,433    |
| 12 | Malishevë             | 15,169,577   |
| 13 | Rahovec               | 14,584,321   |
| 14 | Lipjan                | 17,108,159   |
| 15 | Shtime                | 7,640,553    |
| 16 | Suharekë              | 16,664,992   |
| 17 | Shtërpçë              | 3,680,252    |
| 18 | Kllokot               | 1,100,660    |
| 19 | Gjilan                | 28,167,826   |
| 20 | Viti                  | 12,678,123   |



|    |               |            |
|----|---------------|------------|
| 21 | Novobërdë     | 2,859,925  |
| 22 | Ferizaj       | 31,899,726 |
| 23 | Klinë         | 10,861,584 |
| 24 | Pejë          | 27,837,808 |
| 25 | Istog         | 11,254,268 |
| 26 | Glllogoc      | 15,742,516 |
| 27 | Skenderaj     | 14,458,647 |
| 28 | Vushtrri      | 19,318,682 |
| 29 | Gjakovë       | 26,857,955 |
| 30 | Deçan         | 10,113,463 |
| 31 | Dragash*      | 9,074,329  |
| 32 | Junik*        | 1,573,989  |
| 33 | Kamenicë      | 10,914,818 |
| 34 | Leposaviq*    | 4,406,497  |
| 35 | Partesh*      | 1,075,129  |
| 36 | Ranillug*     | 1,592,418  |
| 37 | Kaçanik       | 8,922,175  |
| 38 | Hani i Elezit | 2,560,340  |

\*Institucionet lokale, auditimi i së cilave do të përkrahët nga kompania private e auditimit.

**Tabela 4: Ndërmarrje publike [12]**

|    | Entitetet nën auditim                      |  |
|----|--|--|
| 1  | Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a      |  |
| 2  | Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a      |  |
| 3  | KRU "Hidromorava" sh.a - Gjilan            |  |
| 4  | KRU "Hidroregjioni Jugor", sh.a - Prizren  |  |
| 5  | KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë           |  |
| 6  | Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë    |  |
| 7  | Telekomi i Kosovës                         |  |
| 8  | Posta e Kosovës                            |  |
| 9  | KRM "Pastrimi", sh. a - Prishtinë          |  |
| 10 | KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë             |  |
| 11 | Ngrohtorja Qendrore "Termokos" - Prishtinë |  |
| 12 | NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë       |  |

**Tabela 5: Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [14]**

|   | Entitetet nën auditim  |  |
|---|--|--|
| 1 | Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ në Kosovë (MASHT - BB) |  |
| 2 | Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MTI - BB)              |  |
| 3 | Efiçienca e Energjisë së ripërtitshme (MZHE - BB)                    |  |
| 4 | Efiçienca e Energjisë së ripërtitshme (MZHE - BB)                    |  |
| 5 | Zhvillimi Rural dhe Agrobujqësor (MBPZHR - BB)                       |  |


|    |  |  |
|----|--|--|
| 6  | Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA – BB)  |  |
| 7  | Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH - BB)   |  |
| 8  | Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MSH - BB)                                       |  |
| 9  | Përmirësimi i mbrojtjes financiare dhe cilësia e kujdesit (MSH-BB)                         |  |
| 10 | Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MPMS - BB)                                      |  |
| 11 | Pasuria e paluajtshme & infrastruktura gjeohapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës - BB) |  |
| 12 | Projekti “Komunat për rininë në Kosovë” (MPL – BB))  |  |
| 13 | Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë (ZKM - SIDA)      |  |
| 14 | Programi Mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020 (MMPH - SIDA)                                  |  |

## B. AUDITIMET E PERFORMANCËS

Tabela 6: Temat e auditimeve të performancës [17]

|   | Temat nën auditim  |  |
|---|--|--|
| 1 | Vlerësimi i nxënësve në testet kombëtare dhe ndërkombëtare- PISA   |  |
| 2 | Performanca financiare dhe operative e NP Trepça   |  |
| 3 | Sistemi i licencimit dhe monitorimit të hidrocentraleve  |  |
| 4 | Menaxhimi i fondeve publike Radio Televizioni i Kosovës  |  |
| 5 | KEK - Auditimi i kontratave të prokurimit  |  |
| 6 | KOSTT - Auditimi i Projekteve kapitale   |  |
| 7 | Bashkimi i Qytetit Ferizaj - Projekt kapital   |  |
|   | <b>Auditime në fushën e teknologjisë së informacionit</b>  |  |
| 1 | Sistemi i Gjendjes së Regjistrimit Civil   |  |
| 2 | Kontrollet e Informacionit në sistemin e pagave - PAYROLL  |  |
| 3 | Përcjellja e rekomandimeve në RVA 2020 për SIMFK në pjesën e TI-së.  |  |
|   | <b>Auditim me kërkesë</b>  |  |
| 1 | Auditim i performancës –Vendimet lidhur me strukturën organizative dhe vendimet Alpex-KOSTT- Kuvendi i Kosovës.  |  |
| 2 | Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës dhe marrëveshjeve për blerje të energjisë –KOSTT-Kuvendi i Kosoves   |  |
| 3 | Shpenzimet për fondet e mbrojtjes juridike dhe mbështetjes financiare të personave të akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara- Ministria e Drejtësisë (raport jo për publikun). |  |
|   | <b>Auditimet e papërfunduara nga sezoni i kaluar</b>   |  |
| 1 | Granti i Performancës Komunale – DEMOS.  |  |
| 2 | Menaxhimi i medikamenteve dhe materialeve tjera shëndetësore si përgjigje ndaj nevojave të pacientëve me Covid-19.   |  |
| 3 | Organizimi i resurseve njerëzore dhe teknike si përgjigje ndaj nevojave të pacientëve me Covid-19.   |  |
| 4 | Shërbimet e transportit ajror - Kontratë e centralizuar.   |  |





**Zyra Kombëtare e Auditimit**  
**Nacionalna Kancelarija Revizije**  
**National Audit Office**

<http://www.zka-rks.org>